REPUBLIKA E SHQIPËRISË

MINISTRIA E PUNËVE PUBLIKE DHE TRANSPORTIT

Koçesioni për Autostradën MILOT – MORINË

Ftesë për pjesëmarrje në procedurën parakualifikuese

Qeveria e Republikës së Shqipërisë, nëpërmjet Ministrisë së Punëve Publike dhe Transportit (me poshtë referuar si Ministria), do të japë me koçesion me afat të gjatë rehabilitimin, mirëmbajtjen dhe operimin e autostradës Milot-Morinë, e cila lidh qytetet e Durrësit dhe Tiranës me Republikën e Kosovës.

Koçesionari, subjekt i një sërë standartesh performance, do të jetë pergjegjës për operimin dhe mirëmbajtjen e autostradës, duke përfshirë dhe mirëmbajtjen e tunelit të Thirrës 5.6 km të gjatë, me dy korsi, operimin e një stacioni për mbledhjen e tarifës, dublimin e një segmenti 26 km të gjatë të autostradës si dhe ndërtimin e disa strukturave shtesë.

Ministria, në bashkëpunim me konsulentët e saj, ka bërë studimet e duhura për projektin, kopje të së cilit do t'i vendosen në dispozicion ofertuesve të parakualifikuar.

Në zbatim të ligjit nr. 9663, datë 18/12/2006 " Për koçesionet", i ndryshuar dhe Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 27, datë 19/01/2008 " Për miratimin e rregullave të vlerësimit dhe të dhënies së koçesioneve", i ndryshuar, Ministria fton subjektet dhe bashkimet e shoqërive të interesuara, me eksperiencë në operimin, mirëmbajtjen dhe rehabilitimin e autostradave të dërgojnë aplikimet e parakualifikimit për këtë koçesion.

Dokumentat parakualifikuese mund të shkarkohen elektronikisht në faqen zyrtare të MPPT ëëë.mppt.gov.al, mund të merren me anë të një kërkese në adresën e e-mailit të paraqitur më poshtë, ose mund të merren fizikisht në adresën e mëposhtme, në çdo kohë që nga data e publikimit të kësaj ftesë (19 Dhjetor 2011) deri në afatin e fundit të pranimit të dokumentave parakualifikuese (15 Shkurt 2012, ora 15.00) :

Adresa fizike:	Ministria e Punëve Publike Sheshi "Skenderbej", Nr. 5, Tiranë; Shqipëri;
	dhe/ose
Adresa e e-mail :	manjola.malo@mppt.gov.al okudashov@ifc.org

Ofertuesit e mundshëm duhet të dorëzojnë vetëm nje ofertë. Pas dorëzimit të aplikimit parakualifikues, ofertuesit e mundshëm do t'i nënshtrohen detyrimeve të parashikuara në dokumetat parakualifikues. Ofertuesit e mundshëm, njohin dhe pranojnë të gjitha detyrimet që lindin nga nënshkrimi i kësaj kontrate konçesioni.

Ofertuesit e mundshëm duhet të përballojnë të gjitha kostot që burojnë nga përgatitja dhe dorëzimi i aplikimit të parakualifikimit.

Aplikimi i parakualifikimit duhet të dorëzohet në adresën fizike të sipërpërmendur jo më vonë se ora 15:00 (ora lokale), datë 15 Shkurt 2012 .

Për informacione shtesë, lutemi kontaktoni:

Znj. Manjola Malo
Ministria e Punëve Publike dhe Transportit
Sheshi "Skenderbej", Nt. 5, Tiranë; Shqipëri
e-mail: manjola.malo@mppt.gov.al